



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 3
Prishtinë, më 27 janar 2015, në orën 10:00,
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Besnik Bislimi, Ali Sadriu, Duda Balje, Synavere Rysha, Bali Muharremaj, Naim Fetah, Adem Grabovci dhe Hajdar Beqa.

Munguan: Fatmir Limaj.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatorë e komisionit.

Pjesëmarrësit tjerë në takim: Sanije Berisha OSCE, Avni Bytycçi GLPS, Arton Demhasaj ÇOHU, Shefki Kastrati NDI, Qendresa Mulaj ZAP, Ibrahim Gjyliden ZAP.

Mbledhjen e kryesoi: Besnik Bislimi, kryetar i komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 24.12.2014.
3. Inicimi i procedurave për Auditimin e Subjekteve Politike.
4. Shqyrtimi i kërkesës për përzgjedhjen e Auditorëve të jashtëm për Auditimin e Bankës Qendrore të Kosovës.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të veprimit për PEFA 2014- 2016.
6. Inicimi i procedurave për zgjedhjen e Auditorit të Përgjithshëm.
7. Të ndryshme

Kryetari pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari- A jeni për këtë rend dite, a ka dikush diçka në lidhje me rendin e ditës.

Ali Sadriu – Propozoj që pika e katërt e rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës për përzgjedhjen e Auditorëve të jashtëm për Auditimin e Bankës Qendrore të Kosovës. Të shtyhet për një takim të radhës, sepse ata e kanë bërë selektimin e ofertuesve por nuk kemi sqarime të përafërta. Ky auditim është me peshë do të ishte mirë që të vijnë përfaqësues të BQK-së të na japin sqarime specifike.

Kryetari - *Konstatoi që Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike me vendim unanim pajtohet që pika e 4 e rendit të ditës të hiqet.*

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 24.12.2014.

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 24.12.2014, u miratua pa vërejtje.

3. Iniciimi i procedurave për Auditimin e Subjekteve Politike.

Kryetari- Siç e dini, nga viti 2013, përgjegjësia për auditimin e subjekteve politike i ka kaluar Kuvendit, ndërsa procedurat iniciohen përmes Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për përzgjedhjen e së paku 10 auditorëve për të kryer këtë auditim. Ky auditim nuk është bërë as për vitin 2013.

Ali Sadriu – Meqenëse nuk ka pasur auditim për vitin 2013, edhe pse ne si komisioni kemi iniciuar procedurat. Unë mendoj që ne do të duhej të kërkojmë që ky auditim të bëhet për të dy vitet.

Kryetari- A pajtoheni që të kërkoj që ky auditim të bëhet për dy vite, edhe pse sa kam unë informata, ky auditim nuk është bërë sepse shuma e mjeteve të ndara nga Kuvendi ka qenë më e vogël sesa që kanë qenë vlerat e ofertuesve. Mirëpo ne duhet ti rekomandojmë Zyrën se prokurimit për iniciimin e procedurave.

Naim Fetahu – Mendoj se ne duhet ta hapim mundësin për iniciimin e procedurave dhe pastaj ata e vlerësojnë sa a janë mjetet e mjaftueshme a jo në bazë të procedurave të prokurimit që i kanë.

Synavere Rysha – Unë mendoj që shuma për të cilën po flasim është e mjaftueshme për auditimin e dy viteve sepse mostra e auditimit mund të jetë pak më e shkurt por që të jetë brenda standardit që kërkohet me Ligj, dhe mendoj se do të del një auditim mjaft i mirë.

Kryetari- Me rëndësi është që auditimi të jetë sa më unifikues për të gjitha subjektet politike dhe që rezultati të jetë sa më objektiv. Pra të mos ketë vërejtje të asaj natyre që një subjekt të auditohet me të tjera kriterë dhe subjekti tjetër me kriterë tjera. Po ashtu unë kam marr edhe kërkesa nga organizatat e shoqërisë civile të cilat kërkojnë angazhim edhe ma të madh në lidhje me këtë çështje, madje është kërkuar nga ne që të kërkojmë krijimin e një komisioni hetimor që kishte mu marr me financat e partive politike. Megjithëse unë mendoj që nëse ne e bëjmë përzgjedhjen e auditorëve nuk ka nevojë që të shkojmë me komision hetimor. Për mendimin tim komision hetimor do të duhej të kërkojmë vetëm nëse kemi vërejtje substancionale në punën e auditorit. Kjo ishte vetëm sa për informimin e Juaj që ka kërkesa dhe unë do të takohem me përfaqësues të OJQ-ve që ti trajtoj ato dhe ti jap sqarimet e mija.

Hajdar Beqa – Edhe unë mendoj që ne sot të marrim vendim për iniciimin e procedurave të prokurimit, dhe pas përfundimit të procedurave të shohim a kemi ofertues të përgjegjshëm për auditimin e dy viteve. Pra konsideroj që të vazhdohet me procedura.

Synavere Rysha – Desha të ndërlidhem sa i përket komisionit hetimor. Mendoj se auditori e bënë punën e vet dhe ne nuk kemi mundësi që kujt ti tekët me ngrit komision hetimor, sepse këto janë dyshime të pabazuara. Auditori nëse heton pa rregullsi e jep një sinjal për parregullsi dhe në bazë të asaj atëherë ne si komision vendosim se a ka nevojë të shkojmë në hetime më tutje.

Adem Grabovci – Ne duhet të veprojmë në kuadër të kompetencave që i kemi si Komision Mbikëqyrës Financiar. Janë auditorët ata të cilët na ofrojnë të gjeturat dhe nëse ka të gjetura të tilla janë organet e tjera që merren me raste të tilla dhe ne nuk kemi nevojë të shqetësohemi fare. Jam për veprime dashamirëse me OJQ dhe bashkëpunim por kurrësi që t'ia bëjmë qejfin dikujt dhe të hymë në një rrugë ku i tejkalojmë kompetencat tona, pra nuk e marrim te përgjegjësi.

Ali Sadriu – Përgjegjësia e këtij komisioni është trup e kuvendit që trajton materien e ofruar, bënë analiza dhe të njëjtat ia dërgon Kuvendit. Nëse në raport konstatojmë se ka pa qartësi kërkojmë nga auditori të na i jap sqarimet më të përafërta dhe nëse ne si komision jemi të pakënaqur kemi të drejt ta angazhojmë një ekspert tonin por jo të bëjmë komision të pavarur. Komision të pavarur formon vetëm Kuvendi.

Kryetari – Atëherë a pajtoheni që ta nxjerrim një përfundim në lidhje me këtë pikë.

Përfundim

Ngarkohet stafi mbështetës i komisionit që ta hartoj një kërkesë për zyrën e prokurimit që ti inicioj procedurat për përzgjedhjen e auditorëve për auditimin e subjekteve politike.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të veprimit për PEFA 2014- 2016.

Kryetari – Në lidhje me këtë pikë, unë e kam këtu raportin e PEFA-2014- 2016, që ka të bëjë më shpenzimet publike dhe llogaridhënëse në Kosovë. Në këtë raport kanë dal disa rekomandime që prekin edhe performancën e legjislativit. Konkretisht pika 28 e prek edhe këtë komision, ku konsiderohet si sfidë trajtimi i të gjitha raporteve që na vinë nga ZAP-i. Pra ka të bëjë me raportet të cilat nuk kanë arritur të shqyrtohen, pastaj janë raportet e auditimit të komunave dhe

po ashtu ka pasur raste kur nuk kanë raportuar ministrat për atë që është kërkuar. Stafi mbështetës e ka përgatitur një plan të veprimit. Sot me ne është edhe një përfaqësues i ZAP. Auditori e ka bërë të njëjtën punë edhe për rekomandimet që kanë dalë për auditorin e përgjithshëm dhe ata kanë tregu gatishmëri të na ofrojnë edhe ekspertizën e tyre në mënyrë që ne ta bëjmë një plan veprimi që kish me adresua mënyrën se si ky komision donë me ballafaqua këtë sfidë. Prandaj kisha kërkuar nga stafi mbështetës i komisionit që të bashkëpunoj me zyrën e auditorit që ta nxjerrin një plan veprimi të cilin ne pastaj do ta shqyrtojmë.

5. Inicimi i procedurave për zgjedhjen e Auditorit të Përgjithshëm.

Kryetari – Në lidhje me këtë pikë, nuk do të thotë që ne do ti iniciojmë procedurat, por me shumë që të debatojmë për këtë pike sepse ka shume mangësi në legjislacionin ekzistues rreth procedurave të përzgjedhjes. Me Kushtetutë dihet se kush i nominon apo ja sjell parlamentit nominimet, mirëpo cilat janë procedurat, kush e shpall konkursin kush i interviston kandidatet, kush ia jep rekomandimet presidentes, këtu ka një zbrazëti të complete ligjore. Nga stafi mbështetës e kam marr një shkresë me të cilën Kryetari i Kuvendit iu ka drejtuar Presidentes. Mirëpo kjo shkresë vetëm i kujton Presidentes rolin e saj Kushtetues por pa kërkuar prej saj hyrje në procedura. Pra ne po e debatojmë këtu sot AKA mendojmë na kush do të duhej të jetë Institucioni që kish me marr përsipër udhëheqjen e procedurave deri te ardhja e zgjidhjes së Auditorit Gjeneral.

Bali Muharremaj – Ne nuk mund ta shkelim as Kushtetutën e as Ligjet në fuqi. Ne takim që e patëm me kryetaren e Komisionit të Auditimit nga Bundestagu Gjerman, na tha që është mirë që Auditori të jetë jo politik, mirëpo ne gjithë e dimë që kjo në Kosovë pak problem kjo. Ne mund të japim këshilla apo sugjerime por nuk mund të ndërhyjmë në atë që e thotë Ligji dhe Kushtetuta.

Ali Sadriu – Legjislacioni i jonë jo që nuk e ka definuar mire, por ne e kemi këtu një pozicion kundërshtues. Nëse e marrim Ligjin, e shohim që Presidentja nuk involvohet fare. Por pasi që Kushtetuta është akt më i lart juridik atëherë kjo përgjegjësi i takon Presidentes dhe ne nuk do të duhej të ndërhyjmë në përgjegjësit e saj. Në këtë rast në vetëm duhet t'ia kujtojmë që koha ka mbërri për iniciimin e procedurave.

Kryetari – Në fakt kushtetuta thotë vetëm që Presidentja i nominon, nuk thotë që Presidentja i inicion procedurat për përzgjedhjen e Auditorit. Nëse zgjidhet prej parlamentit dhe brenda Kuvendit me këtë detyrë merret komisioni i ynë, atëherë shtrohet pyetja se kush duhet me inicua procesin e zgjedhjes.

Adem Grabovci – Kushtetuta është akti më i lartë juridik dhe ne vetëm mund ta bëjmë një kërkesë për qartësim, sepse marrim përgjegjësi nëse edhe ne bëjmë shkelje. Por më mirë të bëjmë një kërkesë nga zyra e Presidentes për sqarim. Nëse na kthehet që ne duhet ti iniciojmë procedurat atëherë ja qojmë si propozim Presidentes. Mund edhe ta lëmë me kërkesën e Kryetarit të Parlamentit, ai është përgjegjës për këtë dhe të presim deri të na kthehet një përgjigje, pastaj në përputhje me të të ndërmarrim veprime.

Naim Fetahu- Unë mendoj se ne duhet ta respektojmë komunikimin Institucional, të presim përgjigjen prej Presidentes, atëherë nëse kërkohet prej neve për mi zhvillu procedurat deri te propozimet e kandidatëve atëherë ne e marrim përsipër organizimin dhe procedurat për zgjidhjen e kandidatëve. Por gjithësesi duhet të presim prej zyrës së presidentes se çfarë përgjigje do të marrim.

Hajdar Beqa - Edhe unë mendoj që të presim përgjigje dhe jam shumë optimist që Presidentja do të bazohet në Ligjin për Auditorin. Por konsideroj që procedura duhet të kalojë përmes komisionit. Komisioni ta shpall konkursin publik dhe ta dërgoj përmes Kuvendit të Presidentja dhe pastaj Presidentja ta emroj njërin nga kandidatët e mundshëm. Por ky sqarim duhet me shkuar krejt përmes zyrës së Kryetarit të Kuvendit.

Duda Balje – Mendoj se si komisioni nuk e kemi të drejtën të vendosim për këtë. Por mund të kërkojmë përmes kryetarit të na mundësohet të shohim se kush janë kandidatët. Pra të shohim se si kanë arritur deri në rrethin e ngushtë. Poashtu ta kemi një informatë edhe kush ka aplikuar. Nuk kemi të drejtë ta zgjedhim, por së paku si komisioni të mos anashkalohemi sepse kjo e prek direkt punën tonë si komision.

Synavere Rysha – Unë në këtë shkresë nuk e pash një afat të caktuar, ndoshta nuk është etike ajo të caktoj afat Presidentes. Nuk do të kishte qenë keq që komisioni përmes Kryetarit me ja rikujtonte dhe me ja dhënë një afat që Presidentja ta sqarojë a duhet ne si Kuvend mi inicu procedurat apo ata si zyre e Presidentes.

Ali Sadriu – Është mirë që stafi mbështetës i komisionit dhe Ju si kryetar në bashkëpunim me sekretarin të sqaroni këto se çka më tutje. Sekretari mu me ka njoftuar gojariisht që zyra e Presidentes veq e ka filluar një iniciativë. Sepse çdo intervenim i yni i bie si dyfishim i procedurës.

Kryetari – Unë se di si ka mundur zyra e Presidentes të iniciojë procedurat pa e njoftuar Kuvendin dhe pa e njoftuar publikun. Sepse procedura duhet të jetë publike. Është çështje e ndishme kjo. Legjislacioni nuk duhet të jetë i ngurtësuar sepse nëse ne e vërejmë se ka paqartësi dhe zbrastësira ne duhet ta ndryshojmë me kohë.

Naim Fetahu – Pasi që i është bërë me dije Presidentes nga ana e Kryetarit të Kuvendit, dhe neve na kthehet një përgjigje atëherë ajo që na obligohet ne e kryejmë punën tonë. Andaj mendoj se gjithçka çka e diskutojmë më shumë është vetëm humbje kohe.

Adem Grabovci – Mendoj që u than të gjitha, por rruga e vetme është komunikimi me sekretarin sepse sekretari është ai që e ka edhe zyrën logjore që të sqarojë këto çështje. Është mirë që po debatohet në mënyrë kaq të kujdesëshme sepse jemi duke debatuar për një institucion mjaft të rëndësishëm. Sepse po të duam të luftojmë të keqën atëherë ne duhet ta kemi një institucion vërtet të pavarur, që duhet të respektohet dhe të dëgjohet fjala e tij. Prandaj mbetet vetëm të qartësoheni me zyrën e Sekretarit.

Bali Muharremaj – Ne me të vërtetë nuk mundemi me dalë jashtë Kushtetutës as jashtë Ligjeve. Mirëpo më të vërtetë nuk është e mirë kjo. Sepse Auditori është organ i pavarur që i jep llogari Kuvendit a në anën tjetër emërimet i jep Presidentja dhe jo Kuvendi të cilit i përgjigjet. Pra duhet

me kërku më vonë me ndryshu këtë sepse nuk do të kemi sukses në të ardhmën. Pra duhet stafi me Sekretarin dhe me Kryetarin e Kuvendit ta sqarojnë këtë çështje.

Ali Sadriu – Ne si komision për të gjitha çështjet procedurale dhe juridike gjithë mbështetjen që e kemi duhet ta kemi te zyra ligjore e Kuvendit në krye të së cilës është Sekretari. Andaj asgjë tjetër nuk është e udhës përveç sqarimit me Sekretarin.

Kryetari – A pajtoheni që të kërkojm një sqarim shtesë prej zyrës së Sekretarin në lidhje me këtë çështje.

Përfundim

Anëtarët e Komisionit për Mbikqyrjen e Financave Publike u pajtun që të kërkohej sqarim nga ana e zyrës së Sekretarit në lidhje me procedurat e zgjidhjes së Auditorit të Përgjithshëm.

6. Të ndryshme

Në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës Komisioni për Mbikqyrjen e Financave Publike nxorri këto konkluzione:

Konkluzion

1. Mbledhjet e rregullta të komisionit të mbahen kryesisht ditën e martë, ndërsa takimi përgatitor të mbahet një ditë para takimit të rregullt.

2. Të kërkohej nga Sekretari i Kuvendit, që të sigurohet një sallë me prioritet vetëm për Komisionin për Mbikqyrjen e Financave Publike.

Kryetari i komisionit, me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroj mbledhjen të përfunduar.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Besnik Bislimi